



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 20 prill 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Qamile Morina, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Teuta Hadri dhe Vezira Emrush.

Të pranishëm: Xhezair Murati dhe Enis Kervan – deputetë të Kuvendit, Sevi Anac – nga Ambasada Turke, Virtyt Ibrahimaga – ekspert, Nexhat Shatri – nga Zyra e Presidentit dhe Liridon Selmani – KDI.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit - Shpresa Haxhijaj, administratore.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13. 04. 2010 ,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13. 04. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë dhe Komisioni i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratuan procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës;

Sadik Idriz – Tha se para se të shqyrtojmë amendamentet e propozuara nga grupi punues, ju njoftoj se kemi pranuar edhe një amendament shtesë për këtë projektligj nga grupi parlamentar 7 +. Amendamentet do t'i shqyrtojmë nen për nen dhe do t'i votojmë. Grupi punues ka shqyrtuar edhe amendamentet e deputetit Riza Smaka. Nga tri amendamente, vetëm një është pranuar. Amendamenti që e ka bërë grupi parlamentar 7+ ka dalë edhe nga diskutimet që janë zhvilluar edhe në seancë plenare, ku grupi parlamentar 7 + ka qenë i pajtimit që ligji të quhet Ligji për kryqin e kuq dhe Gjysmëhënën e Kuqe. Pasi Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe nuk lejon që organizatat nacionale t'i kenë dy emra, atëherë propozimi i grupit 7 + është që ligji të quhet Ligji për gjysmëhënën e kuqe të Republikës së Kosovës. Komisioni do ta shqyrtojë këtë amendament dhe do ta përkrahë ose do ta refuzojë dhe amendamenti do të shkojë edhe në seancë. Grupi parlamentar 7 + i ka argumentet e veta për këtë amendament. Hap diskutimin:

Flora Brovina – Tha se këto amendamente janë nxjerrë nga diskutimet në Parlament dhe nga takimet e grupit punues me përfaqësuesit e organizatës së Kryqit të Kuq në Kosovë. Edhe në Kuvend është diskutuar për titullin e ligjit, por si jeni të njoftuar ligji nuk mund t'i ketë dy emrat e organizatave edhe të kryqit të kuq edhe gjysmëhënës së kuqe. Të gjithë e dimë se organizata e Kryqit të Kuq të Kosovës ka një traditë të gjatë të funksionimit në Kosovë dhe ka bërë një punë shumë të madhe gjatë luftës në Kosovë. Ne duhet ta vazhdojmë traditën e Kryqit të Kuq në Kosovë. Organizatat e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe janë organizata humanitare të një shteti dhe si të tilla duhet të trajtohen.

Teuta Hadri – Tha se ky amendament i grupit 7 + është i pa nevojshëm, sepse Kosova ka një traditë të gjatë të ekzistimit të Kryqit të Kuq dhe nuk kemi arsye ta ndërrojmë. Edhe në Parlament ligji është miratuar në lexim të parë me këtë titull, prandaj nuk ka nevojë të ndërrohet.

Gjynaze Syla – Tha se debati duhet të zhvillohet në aspektin e trashëgimisë së Kryqit të Kuq që e ka Kosova. Kjo çështja e emrit nuk duhet shikuar në aspektin fetar se kjo është një organizatë humanitare. Çështja tjetër është që Projektligji është miratuar në lexim të parë në Parlament me këtë titull. Propozoj që më tepër të shikohet se a janë të respektuara kornizat e Federatës së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Nurishahe Hulaj – Pajtohet që ligji të quhet ashtu si është edhe tradita në Kosovë, Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Amendamentet e grupit punues janë amendamente të arsyeshme. Kryqi i kuq e ka identitetin e vet me këtë emër dhe kryqi i kuq nuk duhet të dallojë, as racë, as religjion as kufij, por të jetë në shërbim për të gjithë qytetarët.

Vezira Emrush – Tha se të gjitha shtetet e kanë të drejtën e vet ta pranojnë ose kryqin e kuq ose gjysmëhënën e kuqe. Kryqi i kuq ka qenë një organizatë që ka ekzistuar në ish - Jugosllavi. Tani Kosova si shtet ka të drejtë ta ketë organizatën e vet humanitare e që mendoj se duhet të quhet Gjysmëhëna e Kuqe. Pra e përkrah amendamentin e grupit parlamentar 7+.

Rita Hajzeraj – Propozoj që ligji të quhet Ligji për Kryqin e Kuq dhe Gjysmëhënën e Kuqe, por nuk e di se a do të na lejohet ky emër nga Federata e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Projektligji është miratuar në lexim të parë me këtë emër, por ndoshta duhet shikuar mundësin e sponsorimit edhe të një ligji për gjysmëhënën e kuqe.

Sadik Idriz – Tha se rreth 60 shtete si organizatë nacionale e kanë gjysmëhënën e kuqe. Kjo nuk mendoj se duhet të paraqes problem për Kosovën. Megjithatë e drejta e grupeve parlamentare dhe e deputetëve është që të propozojnë amendamente.

Pas diskutimeve Komisioni i votoi një nga një amendamentet e propozuara:

Së pari u votua për amendamentin e propozuar nga grupi parlamentar 7+ :

Në titullin e Projektligjit për Kryqin e kuq të Republikës së Kosovës dhe në tërë tekstin ku përmendet fjala „ Kryq i Kuq “ të zëvendësohet me fjalën „ Gjysmëhëna e Kuqe “

Me 3 vota për dhe 5 kundër nuk u përkrah amendamenti i grupit parlamentar 7+.

Amendament 1

Komisioni Funksional

a) Titulli i Projektligjit të riformulohet:
Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.

Deputeti Riza Smaka

b) Titulli i Projektligjit të riformulohet: Ligji për Kryqin e Kuq dhe Gjysmëhënen e Kuqe të Republikës së Kosovës.

Komisioni me shumicë të votave votoj amendamentin 1, propozimin a) Të propozuar nga Komisioni Funksional.

Amendament 2

Dy propozime:

Komisioni Funksional

a) Në nenin 2, paragrafi 1, riformulohet: „ Kryqi i kuq i Republikës së Kosovës është e vetmja Shoqatë Kombëtare e Kryqit të Kuq në Kosovë, e cila e zhvillon aktivitetin e vet humanitar, vullnetar, jofitimprurës në tërë territorin e Kosovës “.

Deputeti Riza Smaka pa përkrahjen e Komisionit Funksional

b) Në nenin 2, paragrafin 1, të fshihet fjala: „ e vetmja”.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 2, propozimin a) Të propozuar nga Komisioni Funksional.

Amendament 3

Në nenin 2, paragrafin 3, fshihet fjala „ Konventës “ dhe zëvendësohet me fjalën „ Konventave “.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 3.

Amendament 4

Dy propozime:

Komisioni Funksional

a) Në nenin 4, paragrafin 2, fshihet fjalia: „ të gjitha kohërat ” dhe zëvendësohet me: „ çdo kohë dhe rrethanë ”

(Deputeti Riza Smaka pa përkrahjen e Komisionit Funksional)

b) Në nenin 4, paragrafi 2, riformulohet:

Autoritetet publike duhet të përfillin zbatimin e Parimeve Themelore të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe konform me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të adoptuar më 19 nëntor 1946.

Komisioni me shumicë votash, votoj amendamentin 4, propozimin a) Të propozuar nga Komisioni Funksional.

Amendament 5

(Komisioni Funksional)

Në titullin e nenit 6, fshihet fjala „Emblema” dhe zëvendësohet me „ Simbolet”.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 5.

Amendament 6

(Komisioni Funksional)

Në nenin 10, pas nënparagrafit 1.14 të shtohet nënparagraf i ri:

1.4 aftësoj qytetarët për kujdes shtëpiak të të sëmurëve dhe organizoj shërbime shtëpiake.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 6.

Amendament 7

(Komisioni Funksional)

Në nenin 12, paragrafin 1, para nënparagrafit 1.1 shtohen dy nënparagrafët e rinj:

1.1 Shënimin e 27 prillit, ditës së personave të zhdukur në Kosovë.

1.2 Solidarizimin me ditën e fëmijëve jetim më 20 maj.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 7.

Amendament 8

(deputeti Riza Smaka)

Neni 19 të riformulohet:

Për mospërfillje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 13, paragrafët: 1.1, 1.2 e 1.3 dhe nenin 14 paragrafët: 1.7, 1.8 e 1.9, gjykata kompetente për kundërvajtje i cakton dënim me të holla, personit juridik në shumën prej 1000 - 3000 euro, ndërsa personit fizik, përkatësisht përfaqësuesit ligjor të personit fizik, në shumë prej 500 – 1000 euro.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 8 të propozuar nga deputeti Riza Smaka.

Amendament 9

(Komisioni Funksional)

Neni 20 të riformulohet:

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 9.

Komisioni me shumicë votash votoj amendamentet në Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Amendamentet në Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të Kryqit të Kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve;

Amendament 1

(Komisioni Funksional)

Titulli i nenit 8 fshihet dhe riformulohet: „ Dispozitat mbikëqyrëse”.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 1.

Amendament 2

(Komisioni Funksional)

Në nenin 10, në fund të paragrafit 1, fshihet fjalia: „ gjobë prej 1000 - 3000 euro, sipas ligjit në fuqi” dhe zëvendësohet me: „ të holla prej 1000 deri 5000 euro.

Komisioni me shumicë të votave, votoj amendamentin 2.

Amendament 3

(Komisioni Funksional)

Neni 11, të fshihet.

Komisioni me shumicë të votave votoj amendamentin 3.

Amendamenti 4

(Komisioni Funksional)

Neni 15, fshihet dhe riformulohet „, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Forcës së Sigurisë bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe nxjerrjen e akteve nënligjore.

Komisioni njëzëri e votoj amendamentin 4.

3. Të ndryshme

Sadik Idriz – Në mbledhjen e radhës do t’i shqyrtojmë amendamentet e Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale dhe do të zhvillohet një takim pune njëditor. Lidhur me shqyrtimin e kësaj çështje ia japim fjalën edhe ekspertit, z. Virtyt Ibrahimaga.

Virtyt Ibrahimaga – Tha se nga procesverbali i dëgjimit publik kam vërejtur se disa çështje që janë ngritur gjatë dëgjimit publik nuk janë të inkuorporuar në Ligj. Organizimi dhe statusi i AKPM - së nuk janë sqaruar mirë. Gjithashtu autorizimet e AKPM - së nuk janë të precizuara me ligj. Ligji është mjaft teknik dhe nuk adreson shumë çështje.

Rita Hajzeraj- Tha se ligji është mjaft i ndërlikuar dhe ka pasur shumë vërejtje në dëgjimin publik të organizuar. Ky ligj është ligj për produkte dhe pajisje medicinale, e jo për ndërrimin e statusit të AKPM - së.

Teuta Hadri – Tha se kërkojmë edhe nga eksperti, që me anë të amendamenteve të mundohemi t’i përfshijmë të gjitha shqetësimet e palëve në dëgjimin publik.

Qamile Morina- Tha se ligjet e rajonit në të njëjtin ligj e kanë edhe statusin edhe funksionimin e AKPM - së. Ne duhet të shikojmë edhe funksionimin e AKPM - së në vendet e rajonit.

Sadik Idriz – Tha se pasi Projektligji nuk është ende i përfunduar dhe e kemi kaluar afatin prej 2 muaj për shqyrtim, atëherë propozoj që të kërkojmë nga kryesia afat shtesë prej 1 muaj për shqyrtimin dhe përfundimin e amendamenteve.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit, afat shtesë prej një muaj për shqyrtimin e Projektligjit. Komisioni, po ashtu, u pajtua që të mbahet një takim pune, një ditore për propozimin e amendamenteve në këtë Projektligj dhe që në grup punues të kyçen edhe deputetët Nurisha Hula dhe Gjylnaze Sylaj.

Gjithashtu në punëtorinë një ditore u propozua të shqyrtohet edhe dokumenti i propozuar nga UNDP-ja lidhur me gjendjen në shëndetësi.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz